



Prishtinë: 15.11.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1073_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_1886_11_18**;

në seancën e mbajtur më datë 15.11.2018, nxori këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **H. LI. "M. P."**, nga Sllatina e Madhe, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 26.05.2016 konsumatori të përfaqësuar nga H. LI. me shifër DFE - 9028443 ka parashtruar ankesë me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me kontestimin e faturës së energjisë elektrike të muajit janar 2016, si dhe faturimit të energjisë elektrike nga viti 2011.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 24.02.2016 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar në tërësi faturën e muajit janar për arsye se në dhjetor kam një ndryshim të jashtëzakonshëm.

Provë: Ankesa e konsumatorit e datës 24.02.2016

Me datë 23.11.2016 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke refuzuar ankesën e tij bazuar në të dhënat e softuerit CRMS dhe leximet nga AMR rezulton se në muajin janar 2016 është bërë mbilëxim, mirëpo është balancuar në muajin shkurt 2016.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 18.04.2016

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-s konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO, si dhe ka kërkuar që të rishikohet faturimi i energjisë elektrike. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se faturimi është bërë në mënyrë joreale dhe paushall, pasi ngarkesa e tij nuk ndryshon. Konsumatori në ankesë ka theksuar se ngarkesa e tij nuk ndryshon dhe se për këtë dyshon se faturat e energjisë elektrike janë të larta. Konsumatori gjithashtu ka theksuar se ka parashtruar ankesë për periudhën 01/2016 dhe 02/2016 si dhe për shkak të kësaj është detyruar të verifikoj edhe faturat tjera nga periudha 2010 deri më 2016.

Provë: Ankesa e konsumatorit



Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) të lëshuar nga Divizioni i Shpërndarjes së KEK-ut me datë 17.08.2010 për konsumatorin "M. P." me pronar H. LI, i cili PEE është lëshuar për veprimtarinë pishinë dhe restoran në fshatin Sllatinë, me fuqi të instaluar prej 104.5 kVA dhe me fuqi të njëkohshme prej 55 kW. Në PEE përveç tjerash, Bordi i ZRRE ka vërejtur se KEK atëkohë ka theksuar se matja e energjisë elektrike duhet të bëhet me matës elektrik multifunksional (aktiv, reaktiv dhe maksigraf) të lidhur përmes TMRR me 100/5. Pas kësaj Divizioni i Shpërndarjes së KEK-ut me datë 06.10.2011 i ka lëshuar konsumatorit "M. P." me pronar H. LI. Pëlqimin Elektroenergjetik të reviduar në të cilën është theksuar se ndryshimi ka PEE i parë është te kushtet e furnizimit dhe se të gjitha pikat tjera mbeten të njëjta.

Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik nr.4075 i datës 17.08.2010 dhe Pëlqimi Elektroenergjetik nr.5107 i datës 06.10.2011

Bordi i ZRRE ka analizuar procesverbalin mbi montimin dhe demontimin e grupit matës nr.000992 të datës 22.04.2016 dhe kanë vërejtur se gjatë inspektimit punëtorët e autorizuar të KEDS kanë dalur te konsumatori për të bërë ndërrimin e grupit matës, ku kanë ndërruar grupin matës nr.96257221 me gjendje TL=25483.268 kWh dhe TU=13996.577 kWh, si dhe TL=7158.082 kVar dhe TU=3558.261 kVar, si dhe konstantë C=20, si dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr.51284430 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh, si dhe TL=00000 kVar dhe TU=000000 kVar, si dhe konstante C=20. Gjithashtu është vërejtur se në procesverbal është theksuar se është bërë ndërrim i grupit matëse për arsye grupi matës ka regjistru në tarifën 281 dhe 282, dhe se grupi matës i vendosur bllobohet në rregull.

Provë: Procesverbali mbi montimin dhe demontimin e grupit matës nr.000992 i datës 22.04.2016

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes edhe shpenzimin e energjisë elektrike, respektivisht rrjedhën e energjisë elektrike dhe bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore, përveç muajit dhjetor 2015 dhe janar 2016 kur vërehet se ka mbilexim. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin elektrik aktiv nr.96257221 krahasuar me shpenzimet e regjistruara njehsorin e ri nr. 51284430 konstatohet se konsumatori nuk ka ndonjë ndryshim të madh të shpenzimit të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE me qëllim që të paraqet sa më qartë shpenzimet e konsumatorit ka bërë analizimin e konsumit të energjisë së konsumatorit me dy njehsorët elektrik. Për periudhën 02/2011 deri në periudhën 04/2016 me njehsorin elektrik kontestues nr.96257221 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë **12,533.25 kWh/muaj**, me njehsorin nr.51284430 prej periudhës 04/2016 deri në periudhën 108/2018 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është **14,939.25 kWh/muaj**. Sipas krahasimit të bërë konstatohet se konsumatori me njehsorin aktual në krahasim me njehsorin kontestues nr.96257221 nuk ka ndonjë ndryshim të shpenzimit. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike sipas viteve me të dy njehsorët elektrik: 2011 – 17,191.23 kWh/muaj; 2012 – 12,710.35 kWh/muaj; 2013 – 9,718.87 kWh/muaj; 2014 – 9,411.28 kWh/muaj; 2015 – 12,424.87 kWh/muaj; 2016 – 10,313.12 kWh/muaj; 2017 – 14,034.83 kWh/muaj; 2018 – 21,314.80 kWh/muaj. Pra nga kjo shihet qartë se shpenzimi i energjisë elektrike sipas viteve nuk ka ndonjë ndryshim të madh të shpenzimit mes njehsorit kontestues nr.96257221 dhe njehsorit elektrik nr.51284430.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike

Në përgjigjen e KESCO dhënë konsumatorit është theksuar se në të dhënat e softuerit CRMS dhe leximet nga AMR rezulton se në muajin janar 2016 është bërë mbilexim, mirëpo është balancuar në muajin shkurt 2016. Lidhur me këtë KESCO nuk ka dhënë ndonjë sqarim shtesë lidhur me faturimin e bërë për periudhën janar 2016 në të cilën është theksuar se është bërë mbilexim dhe se balancimi është bërë në muajin shkurt 2016. Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike ka vërejtur se në muajin janar 2016 konsumatori është ngarkuar me shpenzim prej 32,113.20 kWh dhe atë si shpenzim mujor, ndërsa në muajin shkurt 2016 është faturuar me



shpenzim prej 8,950.40 kWh. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të muajit dhjetor 2015 dhe ka vërejtur se shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit në muajin dhjetor 2015 ka qenë 2,885.00 kWh. Nga analiza e bërë këtyre tre periudhave kohore vërehet qartë se konsumatori nuk ka lexim në periudhën dhjetor 2015, ndërsa në periudhën janar 2016 ka lexim të shpenzimeve dhe ka grumbullim të shpenzimeve, por që KEDS këtë grumbullim ka theksuar se e ka balancuar në muajin shkurt 2016. Duhet theksuar se gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike, vërehet se shpenzimi i faturuar në muajin dhjetor 2015 është më i ulët se shpenzimi mesatar i konsumatorit, shpenzimi i faturuar në muajin janar 2016 është më i lartë se shpenzimi mesatar i konsumatorit, si dhe shpenzimi i faturuar në muajin shkurt 2016 është përafërsisht i ngjashëm si shpenzimi mesatar i konsumatorit Bordi i ZRRE-së ka bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike të këtyre tre muajve për të parë se pas shpërndarjes a do të mund të kishte konsumatori elemente të korigjimit financiar, por që nuk ka rezultuar me korigjim pasi siç edhe KEDS-i ka theksuar mbileximi i bërë në muajin janar 2016 është balancuar në muajin shkurt 2016

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 15.11.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: H. Ll.
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.